



NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËNITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#108

PËRVJETORI/ 2 vjet Qendra e Botimeve për Diasporën



Një shtëpi botuese, një qendër botimi, merr kuptim kur ka aq libra sa të mund të hartojë katalogun e saj. Është kartvizita më e mirë për punën e bërë. Qendra e Botimeve për Diasporën ka sot, pas dy viteve të funksionimit të saj, Katalogun e parë të Botimeve me mbi 50 tituj.

Vetë hartimi i katalogut është dëshmi e strategjisë së ndjekur në këto dy vite në ndihmesë të shkollave shqipe në mërgatë. Katalogu është ndarë në disa kapituj që përbëjnë dhe drejtimet e punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

VIZITA/ Studentët ukrainas në Shqipëri, njihen me traditat popullore

Një grup nxënësish nga Ukraina po vizitojnë këto ditë Shqipërinë. Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore organizoi një koncert për ta, ku u njohën dhe me traditat shqiptare.

Ky aktivitet zhvillohet në zbatim të programeve që Agjencia ka për shqiptarët e Ukrainës. Çjatë koncertit u interpretuan edhe valle tradicionale të përbashkëta midis trupës profesioniste të Ansamblit dhe nxënësve të ardhur nga Ukraina. Para fillimit të pandemisë, në kuadër të marrëveshjes me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit janë organizuar klasa të mësimi të valleve dhe kulturës shqiptare për komunitetin shqiptar në Karakurt, Tyushki, Divnyns ke dhe Gamovka.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

QBD/ Katalogu i parë i botimeve, mbi 50 tituj



Pas dy viteve të funksionimit të saj, QBD sjell Katalogun e parë të Botimeve me mbi 50 tituj. Një shtëpi botuese, një qendër botimi, merr kuptim kur ka aq libra sa të mund të hartojë katalogun e saj. Është kartvizita më e mirë për punën e bërë.

Vetë hartimi i katalogut është dëshmi e strategjisë së ndjekur në këto dy vite në ndihmesë të shkollave shqipe në mërgatë. Katalogu është ndarë në disa kapituj që përbëjnë dhe drejtimet e punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Në pjesën e parë janë paraqitur tekste mësimore të hartuara në mbështetje të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. Në një ndarje më vete janë paraqitur materialet mësimore bazë për hartimin e platformës digjitale: "Mëso shqip", të miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

LETRA NGA DIASPORA/ Bordi letrar diskuton përgatitjet për numrin e dytë

Bordi i revistës letrare "Letra nga Diaspora" në një mbledhje online diskutoi mbi numrin e parë të revistës "Letra nga Diaspora" dhe përgatitjen e numrit të dytë.

Drejtoresha, znj. Mimoza Hysa i prezantoi bordit projektin e revistës dhe kryeredaktorja, znj. Arta Marku, prezantoi përmbajtjen, rubrikat, autorët dhe krijimtarinë e përzgjedhur për numrin e dytë. Ashtu si numri i parë i saj, edhe numri i dytë do të përmbajë rubrikat: Dialog, Dossier, Letrat, Nonfiction, Urat, Përtej letërsisë dhe Botimet e reja.

Anëtarët e bordit e vlerësuan punën e bërë nga QBD-ja dhe redaksia e revistës, parashtruan sugjerimet e tyre për rubrika të veçanta, si dhe për mënyrën e promovimit dhe shpërndarjes.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Dhuro Libra



Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.